



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 10. 2016, pas shqyrtimit të propozimit të vendimit të Kryetarit të Komunës, miratojë këtë

V E N D I M

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI –KKSBS-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të KKSBS-së

Me këtë Vendim zëvendësohet anëtarja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi Znj. Dragana Trajković nga komuniteti serb, në numrin rendor 7 të pikës I të Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSBS në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 të datës 29.01.2014 dhe në vend të saj caktohet z. Zoran Radiq nga komuniteti serb në Lipjan në pajtim me shkresën –kërkesën e komunitetit serb nr. 1-031-55797 të datës 07.10.2016.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSBS-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSBS në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 të datës 29.01.2014.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

Neni 4

Ky Vendim është i hartuar në tri kopje origjinale

15.Nr. 020-6448
Lipjan, me 31. 10. 2016

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESJA
Vlora Limani – Hajnuni

